

UDHËZIM
Nr. 54, datë 20.3.2025

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT TË
MINISTRIT TË BRENDSHËM DHE MINISTRIT TË FINANCIVE DHE
EKONOMISË NR.100, DATË 20.7.2023, “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË DHE TË HUAJ ME DOKUMENTE
BIOMETRIKE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 5, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar; të pikës 8, të vendimit nr. 80, datë 14.2.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin e përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr.100, datë 20.7.2023, “Për përcaktimin e tarifave për pajisjen e shtetasve shqiptarë dhe të huaj me dokumente biometrike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1.Në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

- a) në fjalinë e parë, pas fjalës “Tarifat...” shtohet togfjalëshi “për blerjen e kuponit fizik ose elektronik...”;
- b) tabela ku paraqiten tarifat për blerjen e kuponit fizik ose elektronik për pajisjen me dokumente biometrike, zëvendësohet me tabelën, si më poshtë:

Kategoria	Emërtimi	Vlera e kuponit	Monedha	Vlera në lekë		
				Vlera pa TVSH	TVSH	Total
Letërnjoftim	Standard	1,500	LEK	1,500	0	1,500
	Për ambasadë (ITA, GRC)	12	EUR	1,354	0	1,354
	Për aplikim të shpejtë	3,00	LEK	3,000	0	3,000
	Për Ambasadën në SHBA	18	USD	1,879	0	1,879
	Për ambasadat në vendet EU	16	EUR	1,805	0	1,805
	Për Ambasadën në Mbretërinë e Bashkuar	13	GBP	1,673	0	1,673
	Për ambasadën në vendet Aziatike	18	USD	1,879	0	1,879
	Për Ambasadën në Zvicër	18	CHF	2,060	0	2,060
	Për Ambasadën në Danimarkë	-	DKK	-	-	-
Pasaporta	Standard	7,500	LEK	6,250	1,250	7,500
	Për aplikim të shpejtë	18,00	LEK	15,000	3,000	18,000
	Për ambasadë (ITA, GRC)	130	EUR	12,222	2,444	14,666
	Për Ambasadën në SHBA	240	USD	20,883	4,177	25,059
	Për ambasadat në vendet EU	170	EUR	15,982	3,196	19,178
	Për Ambasadën në Mbretërinë e Bashkuar	130	GBP	13,942	2,788	16,730
	Për ambasadën në vendet Aziatike	240	USD	20,883	4,177	25,059
	Për Ambasadën në Zvicër	240	CHF	19,460	3,892	23,352
	Për Ambasadën në Danimarkë	-	DKK	-	-	-
Leje qëndrimi	Për leje qëndrimi	5,700	LEK	4750	950	5,700

Letërnj. udhëtimi	refugi. dok.	Standard ID	1,500	LEK	1,500	0	1,500
		Standard për pasaporta	7,500	LEK	6,250	1,250	7,500

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj